



**Ani Mbrica, PhD**

**Lektore**

**Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë  
Tirana Business University College**

Ani Mbrica ka përfunduar studimet e larta me rezultate të shkëlqyera në Universitetin Bujqësor të Tiranës në specialitetin “Ekonomist Agrobiznesi” në vitin 2005. Në vitin 2006 vazhdoi studimet në Itali duke ndjekur masterin ndërkombëtar të nivelit të dytë “Environment and Health” në Università degli Studi della Tuscia. Në vijim ndoqi studimet e doktoraturës në "Economics and Local Development” po në Università degli Studi della Tuscia, ku në përfundim mori titullin Doctor of Philosophy. Gjatë periudhës së studimeve doktorale ajo fitoi mundësinë për të ndjekur një internship në Komisionin Evropian - Drejtoria e Përgjithshme për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Tetor 2010 -Shkurt 2011).

Pas studimeve të ciklit të dytë punoi si eksperte pranë German Corporation for International Cooperation GIZ (2007-2009).

Ani Mbrica ka një eksperiencë 15 vjeçare në mësimdhënie në arsimin e lartë privat me kohë të plotë, pranë Universitetit European të Tiranës dhe në arsimin e lartë publik me kohë të pjesshme në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Fushat kërkimore ku ajo përqendrohet përfshijnë sjelljen organizative, sjelljen sipërmarrëse, anët e errëta të sipërmarrjes, politika e zgjerimit të BE-së, turizmi dhe zhvillimin rural. Disa nga punimet e saj shkencore janë prezantuar në konferenca ndërkombëtare dhe janë botuar në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit.